



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Seanca nr. 02-09/05

Prishtinë, më 6 dhe 7 korrik 2005

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi **Nexhat Daci**, kryetar i Kuvendit, por i ndihmoi **Gazmend Muhaxheri**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 91 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryesia ia kishte propozuar Kuvendit këtë

REND TË DITËS:

1. Shqyrtimi i gjendjes ekonomike në vend;
2. Shqyrtimi i rekomandimeve për çështjen e pensionistëve në Kosovë

Në fillim të seancës, kryetari kërkoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë e veçantë – miratimi i një rezolute në shenjë përkujtimi të dhjetëvjetorit të masakrës së Srebrenicës, që e miratoi Kuvendi.

1. Shqyrtimi i gjendjes ekonomike në vend

Kryeministri i Kosovës, **Bajram Kosumi**, paraqiti gjendjen aktuale të zhvillimit ekonomik të vendit, si dhe aktivitetin e Qeverisë së Kosovës për: zhvillimin makroekonomik të vendit; hartimin e legjislacionit që rregullon fushën ekonomike;

strategjinë e zhvillimit; planin hapësinor të Kosovës; politikat ekonomike; privatizimi; financat dhe investimet; tregtia; bujqësia; transporti; puna dhe mirëqenia sociale; kthimi dhe lëvizja e lirë; shëndetësia dhe problemi i papunësisë. Po të merret parasysh aktivitetin e Qeverisë në fushat e cekura më lart, shtoi kryeministri, Kosova duket se me sukses po kalon nga faza e rindërtimit në fazën e një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm.

Fjalimi i plotë i kryeministrit i është bashkangjitur transkriptit.

Shefi i shtyllës së katërt të UNMIK-ut, z. **Jokaim Ryker**, në diskutimin e tij u përqendrua në sfidat e transformimit të ekonomisë së sistemit të kaluar në një ekonomi të tregut; përmbushjen e standardeve; problemet e papunësisë; disbalanci ndërmjet importit dhe eksportit; privatizimit – deri në fund të këtij viti rreth 90 % e ndërmarrjeve shoqërore do të privatizohen; investimet e huaja; thithja e kredive nga bankat ndërkombëtare; përkufizimet fiskale, si dhe për planin zhvillimor të Kosovës. Kosova do ta ketë një ekonomi të qëndrueshme, që mbështet në përparësitë e saj krahasuese me vendet e rajonit, e integruar në tregun regjional, sipas standardeve evropiane. Diskutimi i plotë i z. Ryker i është bashkangjitur transkriptit.

Kryetari e ftoi propozuesin e kësaj pike ta arsyetonte atë para deputetëve të Kuvendit.

Veton Surroi, në emër të ORA-së, paraqiti problemet për gjendjen ekonomike të vendit, si: Kosova në tre vjetët e fundit ka pasur stagnim ekonomik, kurse tani ka degradim; rritja e numrit të punëkërkuësve; problemet rreth privatizimit – deindustrializimi i vendit dhe bllokimi i mjeteve nga ndërmarrjet e privatizuara; kërkesat në rritje për kredi; mos mbrojtja e prodhimeve bujqësore; debalansi ndërmjet importit dhe eksportit; menaxhimit jo mirë me paratë publike etj. Të gjithë treguesit ekonomikë tregojnë, shtoi Surroi se Qeveria e Kosovës nuk ka vizion për zhvillimin ekonomik të vendit. Diskutimi i plotë i deputetit Surroi i është bashkangjitur transkriptit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me gjendjen ekonomike në vend dhanë këta deputetë: **Alush Gashi; Jakup Krasniqi, Gjylnaze Sylaj, Mahir Jakxhillar, Bajram Rexhepi, Naser Osmani, Haki Shatri, Gani Koci, Behxhet Brajshori, Naim Maloku, Nekibe Kelmendi, Fatmir Rexhepi, Fehmi Mujota, Teutë Sahatçia, Xhavit Haliti, Mazllun Kumnova, Gjergj Dedaj, Xhezair Murati, Xhevdet Neziri, Safete Hadërgjonaj, Ramadan Kelmendi, Brikenda Kryeziu, Afrim Azuralxhiu, Sevdije Halimi, Berat Luzha, Ylber Hysa, Bajrush Xhemajli, Demir Lima, Nazim Jashari, Flora Brovina, Fadil Geci, Besa Gaxheri, Ymer Halimi, Hatixhe Hoxha, Fatmire Kollçaku, Zylfije Hundozi, Nagip Zekolli, Xhevat Bislimi, Gazmend Muhaxheri, Ferid Agani, Sala Berisha, Hajredin Kuçi, Sanije Aliaj dhe Nexhat Rexha**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

2. Shqyrtimi i rekomandimeve për çështjen e pensionistëve në Kosovë

Kryetari i informoi deputetët për takimet që kishte pasur me përfaqësuesit e Shoqatës së Pensionistëve lidhur me problem e çështjes së pensioneve.

Fatmire Kollçaku, kryetare e Komisionit për Punë, Mirëqenie Sociale dhe Shëndetësi i paraqiti rekomandimet dhe propozimet e këtij komisioni lidhur me çështjen e pensioneve.

Kryetari e hapi debatin lidhur me çështjen e pensionistëve.

Opinione, vërejte dhe sugjerime lidhur me çështjen e pensionistëve dhanë këta deputetë: **Naim Jerilu, Gjylnaze Syla, Zahrije Isufi, Teutë Sahatçiu, Xhezair Murati, Naser Osmani, Flora Brovina, Sabri Hamiti dhe Nazim Jashari**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari i hodhi në votë rekomandimet e Komisionit lidhur me çështjen e pensionistëve. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----76;
Kundër----- 0;
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri i miratoi këto

REKOMANDIME:

1. Udhëzohet Qeveria e Kosovës ta hartojë Projektligjin për sigurimet pensionale, që duhet të përfshijë sistemin e zbatuar nga Trusti i Pensioneve të Kosovës dhe Skemën e Pensioneve, të menaxhuar nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale
2. Ministria për Punës dhe Mirëqenie Sociale të ndërmerr masa konkrete për reformimin e Skemës të Pensioneve, në mënyrë që nga kjo të përfitojnë personat që kane kontribuar në Fondin e pensioneve të Kosovës. Në të njëjtën kohë përfituesit e tanishëm të kësaj Skeme të mos mbeten pa beneficione, por të barten në Skemën e ndihmës sociale të kësaj ministrie.
3. Qeveria e Kosovës duhet të bashkëpunojë me UNMIK-un, që me rastin e bisedimeve me Qeverinë e Serbisë të përfshihet urgjentisht në agjendë edhe çështja e Fondit të pensioneve, të grabitura nga Qeveria e Serbisë
4. Qeveria e Kosovës ta shqyrtojë mundësinë e rritjes së pensioneve për personat që kanë kontribuar në Fondin e pensioneve të mëparshëm.
5. Qeveria e Kosovës të ndajë mjete shtesë, nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, për Fondin e pensionistëve të punës (pensioneve të plota) dhe invalidëve të punës, në shumën prej një (1) milion € në muaj, përkatësisht gjashtë (6) milion € për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2005.

3. Miratimi i një Rezolute me rastin e dhjetëvjetorit të masakrës së Srebrenicës

Deputetja **Shpresa Murati**, në emër të Komisionit për Gjiqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ... e paraqiti tekstin e kësaj rezolute.

Deputetët e Kuvendit të Kosovës, njëzëri miratuan këtë

REZOLUTË

1. Kuvendi i Kosovës i bashkëngjitet dënimit të gjerë ndërkombëtar të politikës së dhunës gjenocidale, të ushtruar 10 vjet më parë, në Srebrenicë dhe gjithandej në Bosnje e Hercegovinë si dhe në vendet përreth;
2. Deputetët e Kuvendit të Kosovës, ashtu si edhe të gjithë qytetarët e Kosovës, bashkëndjejnë dhembjen e qytetarëve të mbetur të Srebrenicës dhe gjithë Bosnjës e Hercegovinës dhe shprehin pietetin për viktimat, siç ndjejnë edhe qytetarët e atjeshëm dhembjen për fatin dhjetëra mija të vrarëve e të masakruarve në Kosovë dhe mija të tjerëve, të rrëmbyer e të zhdukur pa gjurmë;
3. Kuvendi i Kosovës angazhohet për trajtim adekuat të viktimave të gjenocidit, nderimin dhe përjetësimin e kujtimit për ta dhe kompensimin meritore të familjeve të dëmtuara në masakrën e Srebrenicës dhe në të gjitha masakrat tjera;
4. Kuvendi i Kosovës angazhohet për funksionim energjik e efikas të drejtësisë ndërkombëtare dhe dënime meritore kundër autorëve dhe urdhërdhënësve të krimeve të gjenocidit dhe para së gjithash kundër shtetit serb dhe kreatorëve të politikës sistematike dhe të institucionalizuar të sundimit të popujve tjerë dhe shfarosjes së tyre etnike;
5. Kuvendi i Kosovës kërkon nga parlamentarët dhe nga të gjitha forcat demokratike e paqedashëse në Serbi distancim të qartë e pa ekuivokë nga politika vetëvrasëse e gjenocidit dhe bashkëngjitje të vendosur e konstruktive përpjekjeve të përbashkëta për zgjidhje të drejtë, të qëndrueshme e demokratike të çështjeve të pazgjidhura, eliminimin e shkaqeve të konfliktit, pamundësimin e politikave që prodhojnë tragjedi si masakra e Srebrenicës dhe krijimin e perspektivës së paqes, stabilitetit, progresit, bashkëpunimit e fqinjësisë së mirë për të gjithë popujt e rajonit.

Kryetari e deklaroi seancën të mbyllur në orën 12:15 minuta.

Përgatiti

Sektori për Çështje Plenare dhe Procedurale

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Akademik **Nexhat DACI**
